

KUJDES! MOS DËMTO BARKODIN

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2009

SESIONI I

(I DETYRUAR)

VARIANTI **A**

E martë, 2 qershor 2009

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Gjumnazi - drejtimi shoqëror; drejtimi i përgjithshëm

Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në poezi dhe në prozë.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dy pjesët ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e kërkesave të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9a	9b	10a	10b	10c	11a
Pikët														
Kërkesa	11b	11c	12	13a	13b	13c	13d	14	15	16	17	18	19	20a
Pikët														
Kërkesa	20b	21a	21b	22	23	24	25a	25b						
Pikët														

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I**Migjeni****Baladë qytetse**

Mbramë
 qiella dhe hyjt e vramë
 një ngjarje të trishtueshme panë:
 Hije...jo! - por një grue
 me ftyrë të zbetë edhe me sy
 të zez si jeta e saj,
 me buzë të vyshkuna në vaj,
 me plagë në gjoks e stolisun
 me veshje dhe me shpirt të grisun,
 me hije grueje,
 një kens këso bote,
 një fantom uje
 vallzonte valle në rrugë të madhe.
 Dy hapa para, dy hapa mbrapa
 me kambë të zbathun,
 me zemër të plasun.
 Dy hapa djathtas, dy hapa majtas,
 me flokë të thime,
 me ndjesi të ngrime,
 (Dikur,
 kur gjit' e saj me kreni
 shpërtheheshin n'aromë,
 kur ish e njomë -
 atëhere e dashunojshin shumë zotni.
 E sot?)
 Jeta e saj asht kjo vall' e çmendun
 në rrugat e qytetit tonë,
 një jetë e fikun, një jetë e shterun,
 shpirt i molisun, zemër e therun,
 një za vorri, një jehonë
 që vallzon natën vonë
 nëpër rrugët e qytetit tonë.

Për pyetjet 1-7 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

1. Cila nga alternativat e mëposhtme i jep kuptimin dhe tonin skenës ku zhvillohet ngjarja e kësaj poezie?

1 pikë

- A) Nata dhe rrugët bosh sugjerojnë kalbëzimin dhe shkatërrimin.
 B) Nata, rrugët dhe qyteti bosh krijojnë ndjesinë e vetmisë dhe braktisjes.
 C) Vallja natën nxit përshtypjen e qetësisë dhe melankolisë.
 D) Yjet dhe nata nënkuptojnë vdekjen.

2. Në vargun “*një jetë e fikun, një jetë e shterun,*” është përdorur figura e: **1 pikë**
- A) alegorisë
B) metonimisë
C) metaforës
D) simbolit
3. Përdorimi i kllapave në poezi shërben: **1 pikë**
- A) për të tërhequr vëmendjen në detaje plotësuese.
B) për të siguruar më mirë ritmin e poezisë.
C) për të krijuar një atmosferë paqeje në poezi.
D) për të prezantuar alternativat e poetit për zgjidhje.
4. Në cilën nga alternativat e mëposhtme mbiemri është përdorur me kuptim figurativ? **1 pikë**
- A) flokë të thime
B) me veshje të grisun
C) kambë të z bathun
D) buzë të vyshkuna
5. Për ç’qëllim përsëritet disa herë grupi emëror *dy hapa*? **1 pikë**
- A) Për të treguar se gruaja di të vallëzojë.
B) Për të krijuar një refren në poezi.
C) Për t’i shtuar muzikalitet poezisë.
D) Për të krijuar efektin e trokitjes së hapave në rrugë.
6. Në këtë poezi vihet re se, nga pjesët e ligjëratës, është përdorur më pak: **1 pikë**
- A) mbiemri
B) emri
C) folja
D) parafjala
7. Në cilin nga vargjet e mëposhtme sintaksa poetike vjen me rend të ndryshuar? **1 pikë**
- A) Jeta e saj asht kjo vall’ e çmendun
B) një ngjarje të trishtueshme panë
C) atëhere e dashunojshin shumë zotni.
D) vallzonte valle në rrugë të madhe.
8. A mendoni se sfondi ku zhvillohet ngjarja në këtë poezi, është një zgjedhje e drejtë nga ana e autorit? Pse? **2 pikë**
- _____
- _____

9. Poeti e përshkruan gruan në dy plane. Cilat janë ato? Zbuloni **vargun** ku këto dy plane jepen të shkrira në një të vetëm.

a) _____ **2 pikë**

b) Vargu: _____ **1 pikë**

10.

- Në poezi veprimi zhvillohet në dy kohë. Identifikojini ato dhe shpjegoni nëntekstin e këtij përdorimi.

a) Kohët: _____ **2 pikë**

b) Nënteksti: _____ **1 pikë**

- Alternimi i vargut të gjatë me vargun e shkurtër është një nga veçoritë e kësaj poezie. Përse shërben kjo teknikë? **1 pikë**

c) _____

11.

- Cila është figura e stilistikës që zotëron poezinë? Ç' imazh përpiqet të krijojë një përdorim kaq i gjerë i saj?

a) Figura e stilistikës: _____ **1 pikë**

b) Imazhi i krijuar: _____ **1 pikë**

- Gjeni në poezi dy raste kundërvëniesh (kontrastesh), që ju tërheqin më shumë vëmendjen. **2 pikë**

c) _____

12. Zbuloni vargjet ku shprehet revolta e Migjenit. A është kjo revoltë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë? Cilat janë disa nga fjalët kyç që e bartin atë?

3 pikë

13. Shumë lexues mendojnë se kjo është një poezi mjaft e trishtuar.

Mbështetni këtë mendim në formën e një eseje duke u fokusuar:

- në momentet që krijojnë atmosferën e trishtuar.
- në figuracionin dhe detajet e përzgjedhura nga shkrimtari për krijimin e kësaj atmosfere.

8 pikë

Shtjellimi i idesë (13a)	Organizimi dhe struktura (13b)	Stili dhe origjinaliteti (13c)	Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi) (13d)	Totali
2 pikë	2 pikë	2 pikë	2 pikë	13
				8 pikë

PJESA II**Franc KAFKA****Metamorfoza (fragment)**

Kur një mëngjes Gregor Zamza u zgjua pas ëndrrash të trazuara, vuri re se qe shndërruar në një kandër të përbindshme. Rrinte shtrirë me shpinën të fortë si zhguall; sapo ngrinte pak kokën, shikonte barkun e tij të zeshkët e të lakuar, të ndarë në unaza të harkuara, në majë të cilave ishte batanija që gati sa s’binte përtokë. Këmbët e shumta e tepër hollake, në krahasim me pjesën tjetër të trupit të tij të madh, i dridheshin para syve.

“Ç’më paska ngjarë kështu?!” – tha me vete. Nuk ishte duke ëndërruar. Dhoma e tij, një dhomë e vërtetë për qenie njerëzore, ndonëse pak si e vogël, mbahej e qetë në katër muret e saj, si zakonisht. Mbi tryezë, ku ndodhej një koleksion modelesh cohe - Zamza ishte komisioner tregtie, - varej një fotografi, që e kishte prerë para ca kohe nga një revistë e ilustruar dhe e kishte vendosur në një kornizë të bukur, të larë me ar. Ajo paraqiste një zonjë me një kapele dhe shall gëzofi, me trupin e drejtë kalli, që i zgjaste shikuesit një manshon të rëndë, në të cilin i humbiste i tërë parakrahu.

Pastaj vështrimi i Gregorit kaloi nga dritarja; dhe qielli i vrenjtur - trokitja e piklave të shiut mbi zingon e parvazit të dritares- e zhyti në melankoli. “Sikur të flija dhe ca që t’i harroja të gjitha këto marrëzi!” –mendoi. Por kjo qe plotësisht e pamundur, sepse ishte mësuar të flinte në krahun e djathtë, ndërsa në atë gjendje s’kthehej dot në pozicionin që dëshironte.

Sado përpjekje që bëri për t’u rrotulluar nga e djathta, përsëri shembej në kurriz. E provoi nja njëqind herë të mira, mbylli sytë për të mos parë këmbkat që i lëvrinin pa pushim dhe hoqi dorë vetëm kur nisi të ndiejë në atë krah një dhimbje të lehtë e të shurdhër, që s’e kishte provuar kurrë më parë... “Kur zgjohesh çdo ditë kaq herët,- mendoi,- marrosesh fare. Njeriu ka nevojë të ngopet me gjumë...”.

.....Te koka e shtratit të tij u dëgjua të binte lehtas dera.

“Gregor !- dëgjoi ta thërresin. Ishte e ëma. – Vajti ora shtatë pa një çerek. Nuk do shkosh në punë?”

Ç’zë i ëmbël! Gregori u tmerrua kur dëgjoi përgjigjen që i doli nga goja e çapëlyer: Ishte zëri i tij, ai i mëparshmi, por në të përzihej një piskamë e dhimbshme, ajo dilte nga thellësitë e qenies së tij, nuk frenohej dot. Fjalët shqiptoheshin shkoqur vetëm në çastin e parë, pastaj shprisheshin aq keq, saqë zor të kuptohej se ç’thoshin. Gregorit ia kishte ënda t’i bënte shpjegime, por ndërroi mendje, i detyruar nga rrethanat dhe u mjaftua duke thënë: “Po, po. Të faleminderit, nënë. Po çohem...”

Në fillim deshi të ngrihej i pashqetësuar nga askush, të vishej, të hante mëngjesin, pastaj ta vriste mendjen për të tjerat, sepse, - këtë e dinte mirë, - po të rrinte duke vrarë mendjen në shtrat, nuk do të arrinte në asnjë përfundim të logjikshëm...

Batanijen e flaku pa ndonjë vështirësi; mjaftoi të fryhej pak dhe ajo ra përtokë. Më pas punët i shkuan më keq, kryesisht ngaqë ishte tepër i gjerë. Duheshin këmbë e duar për t’u ngritur; por në vend të tyre kishte vetëm putërza të vogla që i lëvrinin pa pushim në drejtime nga më të ndryshmet e që nuk i urdhëronte dot... “Të paktën të mos rri kot në shtrat”, - tha me vete... Provoi të ngrinte nga shtrati në fillim pjesën e sipërme të trupit dhe e ktheu kokën me kujdes nga buza e shtratit. Këtë e bëri pa shumë vështirësi, dhe trupi, megjithë peshën e rëndë dhe volumin, në fund të fundit, ndoqi ngadalë kokën. Por, kur më në fund koka iu var, jashtë shtratit, i hyri frika të vazhdonte kështu më tej, sepse në fund të fundit, po të binte, vetëm një mrekulli do ta shpëtonte pa e plagosur kokën. Dhe pikërisht tani nuk duhej ta humbiste në asnjë mënyrë toruan; më mirë të qëndronte në shtrat.

Në çaste të tilla zakonisht ai i mbërthente sytë fort te dritarja, por, për fat të keq, pamja e mjegullës së mëngjesit, që mbulonte madje edhe anën tjetër të rrugës së ngushtë, të

jepte pak siguri dhe gjallëri. “Ora shtatë,- mendoi, kur u dëgjua përsëri tingëllima e orës. – Ora shtatë dhe gjithë kjo mjegull”. Qëndroi për një çast i qetë me një frymëmarrje të dobët, si të priste nga kjo qetësi rikthimin e gjendjes normale. Por pastaj tha me vete: “Para se të vejë ora shtatë e një çerek, duhet të jem larguar patjetër nga shtrati. Përndryshe, ka për të ardhur ndonjë nga ata të firmës të pyesë, zyra hapet para shtatës”.

Nuk i kishin mbetur as pesë minuta deri në shtatë e një çerek, kur dëgjoi zilen e derës së jashtme. “Ndonjë nga ata të firmës do të jetë”,- tha me vete. Shtangu ndërkohë që putërzat zunë të vallëzonin më shpejt. Për një çast zotëroi heshtja. “Nuk po ia hapin”, - mendoi Gregori, duke e ngrohur veten me një shpresë të kotë. Por, pas pak, kuptohet, shërbyesja shkoi si zakonisht me hap të vendosur të hapte derën. E njohu nga zëri, ishte prokuratori. E pse, vallë, qe i dënuar të punonte në një firmë, ku mungesa më e vogël ngjallte menjëherë dyshimin më të madh? Nuk paska mes tyre të devotshëm e besnikë? A nuk qe e mjaftueshme të dërgohej një çirak për të pyetur, në qenka kjo aq e domosdoshme, - po duhej të vinte prokuratori vetë, si për t’i treguar familjes së shkretë se hetimi i kësaj çështjeje kaq të dyshimtë mund t’i besohet vetëm mendjes së tij?

*Për pyetjet 14-19 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.*

14. Si është transformuar Gregori në një insekt?

1 pikë

- A) Si rezultat i një mallkimi të vjetër.
- B) Askush s’e di dhe askush nuk shqetësohet që ta dijë.
- C) Në botën e Kafkës të gjithë njerëzit shndërrohen në insekte.
- D) Për shkak të diçkaje që ai kish ngrënë një ditë më parë.

15. Nga objektet që ka në dhomë Gregori Zamza ndihet më shumë i lidhur me:

1 pikë

- A) fotografinë e varur në mur.
- B) modelin e koleksioneve.
- C) shtratin.
- D) tryezën.

16. Në **paragrafin e dytë** të këtij fragmenti, autori përqendrohet në:

1 pikë

- A) transformimin e Gregorit.
- B) mënyrën se si ai po e përjeton transformimin.
- C) frikën e Gregorit se mos bëhet vonë.
- D) detaje të jetës së tij të izoluar.

17. Gregori është fajtor:

1 pikë

- A) për shkak të një metamorfoze që është përtej kontrollit të tij.
- B) për shkak të marrëdhënieve të veçanta që ka krijuar me punëdhënësit.
- C) sepse nuk po arrin të organizojë veprimet e veta.
- D) sepse ka krijuar një raport të huaj me veten.

18. Mungesa në punë e Gregorit duket e dyshimtë, sepse:

1 pikë

- A) ai ka disa kohë që po sëmuret shpesh.
- B) ai nuk ka munguar asnjëherë për shkak të ndonjë sëmundjeje.
- C) të gjithë e dinë se kohët e fundit ai po shoqërohet me një vajzë.
- D) ka ca kohë që ai është plogështuar dhe dembelosur.

19. Gregori e ka të pamundur të komunikojë me familjen e tij, sepse:

1 pikë

- A) ata po bërtasin aq shumë sa atij i bllokohen fjalët.
 B) ata e kanë të pamundur ta dëgjojnë përmes derës.
 C) ai po flet në gjermanisht, kurse ata kuptojnë vetëm polonisht.
 D) zëri i tij nuk është më njerëzor.

20.

a) Ç' simbolizon metamorfoza e Gregorit?

1 pikë

b) Kritika e ka vlerësuar fjalinë hyrëse të kësaj novele si një nga më tronditëset dhe më të famshmet e mbarë letërsisë moderne. Ç' e bën atë të tillë?

2 pikë

21.

a) Shkruani të paktën dy arsye se pse Kafka ka zgjedhur ta transformojë Gregorin pikërisht në një zvarranik.

2 pikë

b) Shjeroni nëse Gregori e kupton ose jo rëndësinë e transformimit të vet.

1 pikë

22. Në këtë vepër ka një marrëdhënie të ngushtë midis reales dhe fantastikes. Gjeni dy momente në fragment që e bëjnë këtë histori fantastike të besueshme.

2 pikë

- a) _____
- b) _____

23. Identifikoni dy rrethana në jetën e Gregorit, të cilat mund të kenë shkaktuar tek ai ndjenjën e të qenit jo njerëzor, shumë kohë përpara se ky transformim të ndodhte.

2 pikë

- a) _____
- b) _____

24. Në fragment autori e ka theksuar disa herë orën. Shpjegoni nëntekstin e këtij përdorimi.

1 pikë

25. Gjeni në fragment një situatë absurde dhe shpjegoni pse është e tillë.

a) Situata: _____

1 pikë

b) Shpjegimi: _____

1 pikë